

AKT – THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Bellyfull Delivery” SHPK

Bazuar në vullnetin e ortakëve themelues dhe mbështetur në Ligjin 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare”, ndryshuar me Ligjin nr. 10 475, date 27.10.2011, vendoset si më poshtë:

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia e Shoqërisë.

Neni 1:

Themelimi, Themeluesit, Emri.

Sot më datë 23.01.2024 themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin: “Bellyfull Delivery” Shpk.

Themeluesit e shoqërisë “Bellyfull Delivery” Shpk janë:

1. **Shoqëria MALEVEIRON Ltd**, një shoqëri e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Republikës së Qipros, me numër rregjistrimi 30829593 dhe seli ne : Arch. Makariou G, 1-7, Megaro Mitsi 3, Kati 7, Zyra 711, 1065, Nicosia, Qipro, përfaqësuar nga drejtori Z. Antonios Koupepides, ID Nr. 707267 banues në Kleious 8, 2021, Nicosia, Qipro.
2. **Z. Sidorel Dylja**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 14.06.1978, lindur dhe banues ne Drenovice, Berat, me numer personal H80614002E, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar;
Të cilët redaktojnë këtë Akt-Themelimi, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar dhe ligjin 9723 date 03.05.2007“Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

Neni 2

Objekti i veprimtarisë

Aktivitet në fushën e shpërndarjes dhe transportit të mallrave dhe produkteve të ndryshme. Në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe licencat e Shoqërisë të lëshuara nga organet kompetente, Shoqëria mund të kryejë cdo veprimtari që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi, apo që ndërvaret ose lidhet me aktivitetet e renditura më sipër.



Neni 3

Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

Neni 4

Selia e shoqërisë

Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Rruga Ismail Qemali, Pall. Gener 2, Kati III, Tiranë.

Kreu II

Kapitali i shoqërisë

Neni 5

Vlera dhe pagesa e kapitalit të paguar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.000.000 (një milion) leke. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si vijon :

Lloji i kontributit është në para në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë, i ndarë në 2 kuota si me poshtë:

1. **Shoqëria Maleveiron Shpk**, e cila ka kontribuar në para në kapitalin e shoqërisë me një vlerë prej 600.000 (gjashtëqind mijë) Lek, është zotëruese e 1 (një) Kuote, që i korrespondon 60 % (gjashtëdhjetë për qind) të Kapitalit të Shoqërisë.
2. **Z. Sidorel Dylja**, i cili ka kontribuar në para në kapitalin e shoqërisë me një vlerë prej 400.000 (katërqind mijë) Lek, është zotërues i 1 (një) Kuote, që i korrespondon 40 % (dyzet për qind) të Kapitalit të Shoqërisë.

Kapitali themeltar i shoqërisë është shlyer dhe nënshkruar tërësisht nga ortakët e shoqërisë.

Kreu III

Administratori i shoqërisë.

Neni 6

Emërimi dhe kohëzgjatja e Administratorit.

Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë për një periudhë pesë vjecare (5 vjet), në pajtim me parashikimet e Ligjit 9901 date 14.04.2008, i



ndryshuar. Emërtimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme.

Administrator i kësaj shoqërie caktohet Z. Kejdi Dylja, ID. Nr. J60528058Q.

Kreu IV
Dispozitat Përfundimtare.

Neni 7

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në mbështetje të Kodit të Punës si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private, midis ortakëve, punonjësve dhe personave të tretë, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, mbetet në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë përcaktuar dhe inicialet e emërtimit tregtar.

Modalitet për ndryshimin dhe kompetencat e administratorit, kompetencat dhe marrja e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar, etj, do të rregullohen nga Statuti i Shoqërisë dhe Ligji 9901 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar si dhe Ligji 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar.

Ky akt themelimi është përpiluar në tre kopje me vlerë të njëjta me origjinalin.


Tiranë, më datë 23.01.2024.

ORTAKËT THEMELUES

Maleveiron LTD

Karwan Dylja


Sidorel Dylja


SIDOREL DYLIJA